



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

AD/GJTHPR/18/24

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga A.M në cilësinë e palës së dëmtuar ndaj gjyqtares M.B, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 06.09.2024 nxjerr këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e ushtruar nga A.M në cilësinë e palës së dëmtuar ndaj gjyqtares M.B, për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

A r s y e t i m

A.M në cilësinë e palës së dëmtuar përmes adresës elektronike me datë 28 Gusht 2024 ka paraqitur ankesë disiplinore kundër gjyqtares M.B. Në lidhje me pranimin e ankesës, me datë 29 Gusht 2024 është njoftuar Këshilli Gjyqësor i Kosovës.

Parashtruesi i ankesës ka paraqitur ankesë disiplinore për gjyqtares M.B, duke kërkuar që ndaj gjyqtares M.B të merren masa për shkak të shkeljeve në lëndën PKR.nr.291/23. Sipas parashtruesit të ankesës, gjyqtarja M.B për herë të parë në histori tentim vrasjen e ka ri cilësuar në lëndim të lehtë trupor në fazën e konfirmimit të aktakuzës, pa hy fare në gjykim dhe pa e dëgjuar rrëfimin e këtu parashtruesit të ankesës – palës së dëmtuar. Sipas tij, gjyqtarja në fjalë me vendimmarrjen e saj ka abuzuar me detyrën zyrtare dhe njëkohësisht me dëmtimin e interesave të tij si palë e dëmtuar. Tutje ka deklaruar se një gjë e tillë nuk mund të besohet se është bërë nga mos dija, por gjyqtarja e çështjes ose është e korruptuar ose dikush ka ndikuar në vendimmarrjen e saj. Në fund, ndër të tjerash ka deklaruar se ri cilësimi i veprës penale në këtë fazë ngrit dyshime të skajshme, andaj ka kërkuar që të iniciohet procedurë disiplinore ndaj të njëjtës si dhe gjyqtarja në fjalë të përjashtohet nga gjykimi i

Në lidhje me pretendimet e paraqitësit të ankesës, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se në Aktvendimin PKR.nr.291/23, të datës 17.04.2024, ka dhënë arsye të detajuara për bazën ligjore të nxjerrjes së këtij vendimi (Neni 248 par.2 të KPPRK-se, parasheh si ne vijim: “ Me rastin e marrjes së aktvendimit nga ky nen, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues nuk detyrohet me cilësimin juridik të veprës penale siç është parashtruar nga prokurori i shtetit në aktakuzë”) dhe për faktet mbi bazën e të cilave është marr aktvendimi.

Lidhur me pretendimin “ I bindur se gjyqtarja e rastit M.B ose është e korruptuar në këtë rast, ose dikush keq ka ndikuar në vendimmarrjen e saj”, gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se tek e njëjta nuk mund të ndikohet në asnjë mënyrë dhe për këtë më së miri e di vet këtu parashtruesi i ankesës pasi që sipas saj i njëjti ka tentuar që të ndikoj përmes personave të tjerë në lidhje me trajtimin e kësaj lënde por që nuk ka arritur, ku sipas saj si rezultat i zhgënjimit që nuk ka mundur të ndikoj, tani po mundohet

që të sulmoj pa baze. Tutje ka deklaruar se me këto veprime të palës së dëmtuar po pretendohet të njolloset jo vetëm imazhi i saj si gjyqtare por edhe i gjykatës dhe në përgjithësi të sistemit të drejtësisë.

Gjyqtarja e çështjes ka deklaruar se në cilësinë e gjyqtares, vendimet i mbështet bazuar në ligjet në fuqi dhe me arsye të detajuara që të kuptohen jo vetëm nga juristët por nga çdo lexues tjetër. Në fund ka deklaruar se me përkushtim maksimal dhe profesional gjithmonë i ka respektuar të drejtat e të dëmtuarve ashtu edhe të akuzuarve, duke kthyer përgjigje në të gjitha pretendimet e palëve, brenda seancave gjyqësore a po përmes parashtrësve.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtares dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtares M.B.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Nuk është kontestues fakti se gjyqtarja M.B me datën 17.04.2024 në fazën e konfirmimit të aktakuzës ka nxjerrë Aktvendimin PKR.nr.291/23, sipas të cilit ka miratuar pjesërisht kërkesën e avokatit të të pandehurit sa i përket ndryshimit të kualifikimit juridik të veprës penale dhe ka ri kualifikuar veprën penale nga Vrasje në tentativë nga neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së në veprën penale Lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par. 2 lidhur me par. 1 pika 1.4 të KPRK-së, si dhe ka refuzuar kërkesën e të njëjtëve për hudhje të aktakuzës.

Mirëpo, vërtetimet a po vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë në dëm a po në dobi të palës akuzuese a po palës së dëmtuar, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtaren, a po të pretendohet se gjyqtari i çështjes ka shkelur ligjin, kjo sepse për mënyrën e vendosjes së çështjes, gjyqtarët veprojnë konform ligjit, në bazë të bindjes së lirë, pa asnjë presion apo ndikim nga kushdo qoftë, bazuar në provat/shkresat e lëndës, të thënat e palëve në procedurë si dhe legjislacionit në fuqi.

Pretendimet për vendimmarrje të gabuar në këtë fazë të procedurës, nuk mund të jenë arsye për inicim të procedurës disiplinore për gjyqtaren e çështjes, kjo pasi që Autoriteti Kompetent – Kryetarja e Gjykatës nuk ka kompetencë të vlerësoj a po të komentoj vendimet gjyqësore, kjo kompetencë i takon vetëm gjykatës së shkallës së dytë, që të vlerësoj nëse si rezultat i shkeljeve procedurale a po materiale të bëra nga gjykata e shkallës së parë është bërë konstatim i gabuar i gjendjes faktike a po është shkelur ligji në dëm të të akuzuarit a po palës së dëmtuar. Në bazë të shkresave të lëndës, shihet se Aktvendimi PKR.nr.291/23 i datës 17.04.2023 është ndryshuar nga Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, ku është konfirmuar Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë PP.I.nr.193/2020 e datës 19.08.2023, e që rrjedhimisht aktvendimi PKR.nr.291/23 është shfuqizuar.

Autoriteti Kompetent ka vlerësuar se aplikimi i gabuar dhe jo i drejtë i te drejtës materiale apo procedurale nga ana e gjyqtareve gjatë punës së tyre, mund të jete shkak për ushtrimin e ankesës nga ana e palës së pakënaqur në Gjykatën e instancës me të lartë, e që kjo çështje lidhet me aspektin profesional të gjyqtarit dhe e njëjta mund të shërbej si kriter në vlerësimin e performancës së gjyqtarit të caktuar, por jo të konsiderohet shkelje disiplinore nga ana e të njëjtit.

Pretendimi se gjyqtarja e rastit është korrumpuar a po është ndikuar, janë pretendimet që cilat nuk janë mbështetur me asnjë provë dhe nuk janë argumentuar në asnjë mënyrë nga ana e parashtruesit të ankesës dhe si të tilla mbeten vetëm supozime të palës ankuese.

Autoriteti Kompetent do të shqyrtoj ndaras kërkesën për përjashtimin e gjyqtares M.B nga trajtimi i mëtejshëm i këtij rasti, për çka palët do të njoftohen përmes vendimit me shkrim.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i kësaj gjykate vlerëson se nuk janë shkelur dispozitat e nenit 5 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Andaj, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/18/24, me datë 04.09.2024

Albina Shabani Rama

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë